



Prishtinë: 19.12.2008.

Kodi i ZRRE-së: V\_142\_2008

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK\_R\_165\_12\_08

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: ZRRE/DMK\_R\_165\_12\_08; dhe
5. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

Në mbledhjen e mbajtur më 19 dhjetor 2008 nxori këtë:

### VENDIM

**REFUZOHET** ankesa e konsumatorit Fahri Sylejmani "London Fashion – Butik" (shifra e konsumatorit DPR – 90002106) nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

### Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK në ZRRE me datë 19.02.2008 ka apeluar përgjigjen e KEK – Divizionit të Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 21.01.2008, lidhur me njoftimet për shkyçje dhe gjobave për shkyçje.

- Me datë 10.12.2007 konsumatori ka parashtruar ankesë në departamentin për konsumatorë në KEK duke kundërshtuar gjobat për njoftime për shkyçje dhe gjobat për shkyçje.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në KEK.
- Me datë 21.01.2008, departamenti për konsumatorë në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar në arsyetimin se shkyçjet kanë ndodhur si rezultat i mos pagesave të faturave, gjithashtu i është refuzuar kërkesa për kontratë të ri-programimit të borxhit, ngase dy herë më parë ai nuk iu është përmbajtur kontratës së nënshkruar për ri-programim.  
**Provë:** Përgjigja e KEK-ut.
- Me datë 19.02.2008 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së.
- Me datë 12.03.2003 konsumatori ka nënshkruar me KEK-un Kontratën për rregullimin e borxhit, ku shuma e borxhit të ri-programuar është 1,127.00 € ndërsa këstet mujore kanë qenë 94.00 €. **Provë:** Transaksionet e konsumatorit.
- Me datë 12.04.2005 konsumatori ka nënshkruar prapë me KEK-un Kontratën për rregullimin e borxhit, ku shuma e borxhit të ri-programuar është 2,179.20 € ndërsa këstet mujore kanë qenë 62.60 €. **Provë:** Transaksionet e konsumatorit.



- Me datë 07.11.2005 KEK- u i ka dërguar konsumatorit njoftimin për shkyçje për shkak të borxhit që ka ndaj KEK-ut, ku borxhi i konsumatori deri në atë kohë ka qenë 869.61 € (plus edhe pjesën tjetër të mbetur të KRrB).  
**Provë:** Transaksionet e konsumatorit.
- Me datë 09.12.2005 punëtorët e KEK-ut e kanë shkyçur nga rrjeti elektrik konsumatorin për shkak se nuk iu është përmbajtur kërkesave sipas njoftimit për shkyçje. Me realizimin e shkyçjes nga ekipet e KEK-ut konsumatori është ngarkuar me taksën për shkyçje në vlerë 115.00€  
**Provë:** Transaksionet e konsumatorit.
- Me datë 27.02.2006 KEK- u i ka dërguar konsumatorit njoftimin për shkyçje për shkak të borxhit që ka ndaj KEK-ut, ku borxhi i konsumatorit deri në atë kohë ka qenë 1231.15 € (plus edhe pjesën tjetër të mbetur të KRrB).  
**Provë:** Transaksionet e konsumatorit.
- Me datë 21.03.2006 punëtorët e KEK-ut me anë të urdhëresës për shkyçje e kanë shkyçur nga rrjeti elektrik konsumatorin për shkak se nuk iu është përmbajtur kërkesave sipas njoftimit për shkyçje. Me realizimin e shkyçjes nga ekipet e KEK-ut konsumatori është ngarkuar me taksën për shkyçje në vlerë 115.00€.  
**Provë:** Transaksionet e konsumatorit.
- Me datë 29.03.2006 punëtorët e KEK-ut pas verifikimit të gjendjes tek konsumatori kanë vërejtur se konsumatori është rikyçur në rrjetin elektrik pa lejen e KEK-ut dhe se për shkak të këtij veprimi punëtorët e KEK-ut me anë të urdhëresës për shkyçje sërish e kanë shkyçur nga rrjeti elektrik konsumatorin. Me realizimin e shkyçjes së dytë nga ekipet e KEK-ut konsumatori është ngarkuar me taksën për shkyçje në vlerë 345.00 €.  
**Provë:** Transaksionet e konsumatorit.
- Me datë 05.06.2006 KEK- u i ka dërguar konsumatorit njoftimin për shkyçje për shkak të borxhit që ka ndaj KEK-ut, ku borxhi i konsumatori deri në atë kohë ka qenë 3,284.87 €.  
**Provë:** Transaksionet e konsumatorit.
- Me datë 22.06.2006 punëtorët e KEK-ut me anë të urdhëresës për shkyçje e kanë shkyçur nga rrjeti elektrik konsumatorin për shkak se nuk iu është përmbajtur kërkesave sipas njoftimit për shkyçje. Me realizimin e shkyçjes nga ekipet e KEK-ut konsumatori është ngarkuar me taksën për shkyçje në vlerë 115.00€.  
**Provë:** Transaksionet e konsumatorit.
- Me datë 08.08.2006 punëtorët e KEK-ut pas verifikimit të gjendjes tek konsumatori kanë vërejtur se konsumatori është rikyçur në rrjetin elektrik pa lejen e KEK-ut dhe se për shkak të këtij veprimi punëtorët e KEK-ut me anë të urdhëresës për shkyçje sërish e kanë shkyçur nga rrjeti elektrik konsumatorin. Me realizimin e shkyçjes së dytë nga ekipet e KEK-ut konsumatori është ngarkuar me taksën për shkyçje në vlerë 345.00 €.  
**Provë:** Transaksionet e konsumatorit.
- Me datë 05.12.2006 KEK- u i ka dërguar konsumatorit njoftimin për shkyçje për shkak të borxhit që ka ndaj KEK-ut, ku borxhi i konsumatorit deri në atë kohë ka qenë 4,139.58 €.  
**Provë:** Transaksionet e konsumatorit.



- Me datë 04.04.2007 KEK- u i ka dërguar konsumatorit njoftimin për shkyçje për shkak të borxhit që ka ndaj KEK-ut, ku borxhi i konsumatori deri në atë kohë ka qenë 3,930.39 €.  
**Provë:** Transaksionet e konsumatorit.
- Me datë 14.05.2007 punëtorët e KEK-ut me anë të urdhëresës për shkyçje e kanë shkyçur nga rrjeti elektrik konsumatorin për shkak se nuk iu është përmbajtur kërkesave sipas njoftimit për shkyçje. Me realizimin e shkyçjes nga ekipet e KEK-ut konsumatori është ngarkuar me taksën për shkyçje në vlerë 115.00€.  
**Provë:** Transaksionet e konsumatorit.
- Me datë 28.07.2007 punëtorët e KEK-ut pas verifikimit të gjendjes tek konsumatori kanë vërejtur se konsumatori është rikyçur në rrjetin elektrik pa lejen e KEK-ut dhe se për shkak të këtij veprimi punëtorët e KEK-ut me anë të urdhëresës për shkyçje sërish e kanë shkyçur nga rrjeti elektrik konsumatorin. Me realizimin e shkyçjes së dytë nga ekipet e KEK-ut konsumatori është ngarkuar me taksën për shkyçje në vlerë 345.00 €.  
**Provë:** Transaksionet e konsumatorit.

DMK në ZRRE duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit dhe KEK-ut ka vërejtur se:

1. KEK-u në rastin e konsumatorit ka respektuar procedurat, rregulloret dhe ligjet në fuqi.
2. Të gjitha njoftimet për shkyçje, shkyçjet dhe rikyçjet e konsumatorit janë bërë sipas rregullës mbi shkyçjen dhe rikyçjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë.
3. Sipas nenit 4.7 të Rregullës mbi Shkyçjen dhe Rikyçjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë, ndërmarrja e energjisë ka të drejtë të ngarkoj me një taksë konsumatorin për përgatitjen e njoftimeve të shkyçjes, si dhe me taksë për realizimin e shkyçjes dhe rikyçjes sipas Shtojcës 1: Tabela e Çmimeve dhe Gjobave të Rregullës mbi Shkyçjen dhe Rikyçjen e Konsumatorëve.

DMK në ZRRE pas analizimit të dëshmive të paraqitura i rekomandon Bordit të ZRRE-së që të **refuzojë** ankesën e konsumatorit

Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet e paraqitura dhe ka vendosur që ta **refuzojë** ankesën e konsumatorit për arsyet e paraqitura në rekomandimin e DMK të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente të Prishtinës, brenda **katërmbëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Theranda Beqiri, anëtare

---

Dr. Nysret Avdiu, anëtar

---